

L I G J
Nr. 8679, datë 2.11.2000

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7962, DATË 13.7.1995, “PËR ENERGJINË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Në nenin 13 të ligjit nr.7962, datë 13.7.1995 “Për energjinë elektrike” bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në paragrafin e parë shkronja “b”, fjala “të përtëritshme” zëvendësohet me fjalën “të rinovueshme”.

2. Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Burime të rinovueshme janë:

- energjia diellore në të gjitha aplikimet e saj;
- energjia e erës;
- energjia gjeotermike e të gjitha llojeve;
- energjia hidrike;
- energjia e biomasës në të gjitha aplikimet e saj.”

3. Pas paragrafit të katërt shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“a) Duke filluar nga 1 janari 2001, furnizuesi dhe të gjithë prodhuesit e tjerë të pavarur të energjisë elektrike mbi 2 MW janë të detyruar të prodhojnë, për sistemin elektroenergjitik shqiptar, energji elektrike nga burime të energjive të rinovueshme, në masën 2 për qind të të gjithë sasisë së energjisë elektrike të prodhuar prej tyre nga burime të tjera.

b) Detyrimi i mësipërm vlerësohet i plotësuar edhe duke blerë kuotën e njëvlefshme të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë vendas ose duke e importuar nga vende të tjera. Ky detyrim vlerësohet i përmbushur kur Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dokumenton se energjia elektrike e importuar është e prodhuar nga burime të rinovueshme.

c) Në rastet e mosplotësimit të këtij detyrimi, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ka të drejtë të gjobisë në masën 50-100 për qind të vlerës së këtij detyrimi, si dhe të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përsa kohë që ata të plotësojnë këtë detyrim.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2794, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**